



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.980/2020

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Afrim Shala, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.M. nga fsh. ..., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit P.M., av. Enver Ajvazi të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan -Dega në Kamenicë, P.nr.246/19 datë 22.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 11.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit P.M., av. Enver Ajvazi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, P.nr.246/19 datë 22.09.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, P.nr.246/19 datë 22.09.2020, i akuzuari P.M. nga fshati ..., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën e njëjta gjykatë i ka caktuar dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, të cilin dënim ka për ta arkëtuar në afatin prej 15 ditë nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë të njëjtit do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg. I akuzuari është detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtoi shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi. Gjithashtu i akuzuari është obliguar që në kuptim të nenit 39, par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të arkëtoi shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi. Pala e dëmtuar AKP-ja, zyra në Kamenicë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit P.M., av. Enver Ajvazi për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ose të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim, PPA/II.nr.993/2020, datë 16.10.2020 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e saj dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë në rastin e vendimit për dënimin nuk mori parasysh si rrethana lehtësuese si pranimin e fajësisë, gjendjen e rëndë ekonomiko familjare, i papunësuar, si dhe natyrën dhe peshën e asaj veprë penale të kryer në kohë dhe vend. Në ankesë mbrojtësi thekson se në këtë rast kemi të bëjmë me një dëmtim të prerjes së drunjëve, në sasi prej 3.5 m³, e nëse zberthehet në lartësinë e dënimit është tepër i lartë. Në ankesë mbrojtësi konsideron se nëse do ti shqiptohet dënimi me gjobë dhe i njëjti do të ekzekutohet, nuk do të ndikojë në rehabilitimin social të akuzuarit, por do të ndikoj negativisht në jetën e tij dhe familjen e tij, për këto arsye dhe ato më lartë i propozon gjykatës që ndryshoj vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket lartësisë së dënimit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit që ti shqiptohet dënim me i butë me gjobë, janë të pa bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 70 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën penale të kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepër tjetër penale, gjendjen e tij të vështirë ekonomike, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Gjykata e Apelit, vlerësimin e këtyllë të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar faktin se në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë me gjobë, kjo gjykatë duke pasur parasysh se vjedhja është kryer në pronën shoqërore, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, e duke pasur parasysh se i akuzuari është gjykuar me dënim sikurse në dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar, kjo gjykatë konsideron se

me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e neni 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PA1.nr.980/2020 me 11.12.2020

Bashkëpunëtori profesional
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Afrim shala

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi

Hashim Çollaku